




REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ
<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



KRYETARI I KOMUNËS
MUNICIPAL PRESIDENT
PREDSIEDNIK OPSTINE

Tel / Fax: 038/200-46002
Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net

DATA/DATUM/DATE	
01 NR/BR.	
PËR/ZA/TO	Kuvendin e Komunës
PËRMES/PREKO/THROUGH	Xhavit Zariqi, Kryesues i Kuvendit të Komunës 
NGA/OD/FROM	Kryetar i Komunës z. Agim Aliu 
LËNDA/PREDMET/SUBJECT	Propozim - Vendim për kompensimin e Kryetarëve të këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane për tërë territorin e Komunës së Ferizajt.

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d), lidhur me nenin 40 paragrafi 2 shkronja (c) të Ligjit Nr. 03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008", në mbështetje të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 02/2019 për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane, e konform, neni 51 pika 2.6, të Statutit të Komunës së Ferizajt 01.Nr.50 i datës 28.06.2013, Kryetari i Komunës përmes kuvendit të komunës bënë këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për prezentimin e raportit dhe kompensimin e Kryetarëve të këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane për tërë territorin e Komunës së Ferizajt.

- I. Me këtë Propozim - Vendim bëhet prezentimi i Raportit dhe kompensimi i Kryetarëve të këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane për tërë territorin e Komunës së Ferizajt, të zgjedhur nga data 1 Janar 2024 deri në përfundim të mandatit.
- II. Për punën që do ta kryej Kryetari i Këshillit lokal të fshatit, vendbanimit dhe lagjes urbane, do të kompensohet, në shumën ekuivalente të anëtarëve të komiteteve obligative për çdo takim që do ta mbajë me Kryetarin e Komunës ose me Kryesuesin e Kuvendit, për pjesëmarrje në takime konsultative, debate publike, konsultime publike me qytetarët dhe çështje tjera të caktuara me interes për komunitetin.
- III. Kompensimi i Kryetarëve të këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane bëhet nga mjetet buxhetore të Komunës së Ferizajt.

- IV. Kryetari i Këshillit lokal të fshatit, vendbanimit dhe lagjes urbane, nuk mund të kompensohet apo paguhet për më shumë se 6 (gjashtë) takime brenda vitit kalendarik.
- V. Për zbatimin dhe implementimin e këtij vendimi pas miratimit do të përkujdeset Kryetari i Komunës së Ferizajt, përkatësisht Drejtoria për Administratë të Përgjithshme.

Të bashkangjitur e gjeni;

- *Raportin dhe listën e kryetarëve të zgjedhur.*